



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

LIGJ

Nr. , datë . .2018

“PËR PRODUKTET PLEHRUES”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

QËLLIMI, OBJEKTI, FUSHA E ZBATIMIT DHE PËRKUFIZIME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj për qëllim:

- garantimin e shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe mjedisit nga përdorimi i produkteve plehrues.
- rritjen e efikasitetit në të ushqyerit e bimëve me elementë ushqyes;
- përmirësimin e cilësive fiziko-kimike dhe të pjellorisë së tokës.

Neni 2

Objekti

Ky ligj përcakton rregullat për prodhimin, regjistrimin, tregtimin, përdorimin, kontrollin e cilësisë, gjurmueshmërinë, publicitetin, inspektimin e veprimtarive, që lidhen me produktet plehrues si dhe organizimin dhe funksionimin e strukturave përkatëse.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për:

- produktet plehrues, që regjistrohen, prodhohen tregtohen për t’u përdorur në Republikën e Shqipërisë.
- personat fizikë dhe juridikë që ushtrojnë veprimtari të parashikuara në dispozitat e këtij ligji si dhe të legjislacionit për lejet dhe licencat.

Neni 4 Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ambalazhim” është një ambalazh i mbyllur, që përdoret për të mbajtur, mbrojtur e për të lehtësuar shpërndarjen e produkteve plehrues.
2. “Aplikant ose mbajtës i dokumentit të regjistrimit” është personi apo subjekti, që prodhon një produkt plehrues, që ia beson prodhimin e saj një të treti, ose një personi të emëruar nga prodhuesi, si përfaqësues i autorizuar i tij, për regjistrimin e produktit plehrues.
3. “Azot organik”: azoti që është në përmbajtje të komponimeve kimike organike me origjinë bimore ose shtazore ose i prejardhur direkt nga produktet e përmendura.
4. “Deklarim për produktet plehrues” është specifikimi i përqëndrimit të lëndëve ushqyese, duke përfshirë formën dhe tretshmërinë, të garantuara brenda tolerancave të përcaktuara.
5. “Distributor ose shpërndarës” është çdo person fizik ose juridik në zinxhirin e furnizimit, përveçse prodhuesit ose importuesit, që e bën një produkt plehrues të disponueshëm për tregun.
6. “Dokumentacion shoqërues” është dokumentacioni që shoqëron produktin plehrues.
7. “Drejtoria përgjegjëse për produktet plehrues ose DPPP” është drejtoria që mbulon mbrojtjen e bimëve në ministri.
8. “Elementë ushqyes” janë elementët kimikë, të nevojshëm për rritjen dhe zhvillimin e bimëve. Përveç karbonit (C), oksigjenit (O) dhe hidrogjenit (H), veçanërisht nga ajri dhe uji, elementët kimikë ushqyes klasifikohen si:
 - a) “Elementë ushqyes parësorë ose kryesorë” janë vetëm elementët azot, fosfor dhe potas.
 - b) “Elementë ushqyes dytësorë” janë elementët kalcium, magnez, natrium dhe squfur.
9. “Etiketë” është format i shkruar në letër, plastikë apo material tjetër i ngjashëm me to që i bashkëngjitet një objekti dhe jep informacion për të.
10. “Etiketimi” është vendosja e etiketës në paketimin parësor ose të jashtëm.
11. “Grupet e produkteve plehrues” janë produktet plehrues që kanë të njëjtin emër tipologjik si dhe tipare dhe cilësi të përbashkëta mes tyre.
12. “Gjurmueshmëri” është ndjekja e një produkti plehrues në të gjitha fazat, nga prodhimi deri te përdoruesi i fundit.
13. “Hedhje në treg” është vënia e parë në dispozicion të një produkti plehrues.
14. “Heqje nga tregu” është çdo masë, që synon parandalimin e të bërit të një produkti plehrues në zinxhirin e furnizimit të disponueshëm në treg.
15. “Import” është hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë e produkteve plehrues.
16. “Importues” është çdo person fizik ose juridik banues në Republikën e Shqipërisë, i cili importon një produkt plehrues.
17. “Karbon organik me origjinë biologjike” është karboni organik, i cili është përbërës i komponimeve me origjinë bimore ose shtazore ose rrjedh direkt nga këto produkte, me përjashtim të çdo forme të karbonit organik sintetik.
18. “Komision” është komisioni i regjistrimit të produkteve plehrues.
19. “Korrigjues ose korrektues” janë materialet, që duhet të shtohen në tokë, kryesisht për të modifikuar dhe përmirësuar vetitë kimike anormale të saj, të shkaktuara nga reaksioni, kripshmëria, përmbajtja e natriumit.
20. “Laborator reference” është laborator, që vlerëson cilësinë dhe besueshmërinë e kryerjes së analizave laboratorike për produktet plehrues nga laboratorët e miratuar, si dhe kryen analizat e produkteve plehruese sipas metodave dhe standardeve të përcaktuara.
21. “Lëndë ushqyese komplekse” është lënda ushqyese e lidhur me një ose disa nga molekulat e njohura si agjent kompleksues.
22. “Llojet e produkteve plehrues” janë produktet plehrues që përfshihen brenda një grupi.

23. "Magazinë" është objekti i veçantë që shërben për ruajtjen dhe shpërndarjen me shumicë të produkteve plehrues, te njësitë e tregimit me pakicë.
24. "Magazininim" është koha e qëndrimit të produkteve plehrues në magazinë.
25. "Material organik" është produkti organik me origjinë natyrore, i cili mund të identifikohet si lëndë për prodhimin e produkteve plehruese organo-minerale;
26. "Mikroushqyes ose mikroelementë" janë elementët bor (B), kobalt (Co), bakër (Cu), hekur (Fe), mangan (Mn), molibden (Mo) dhe zink (Zn). Këta elementë janë thelbësorë për rritjen e bimëve, edhe pse në sasi të vogla nëse krahasohen me elementët ushqyes kryesorë dhe dytësorë.
27. "Mikroelement i keluar" është mikroelementi i lidhur me një nga molekulat organike.
28. "Ministër" është ministri, që mbulon fushën e bujqësisë.
29. "Ministri" është ministria, që mbulon fushën e bujqësisë.
30. "Operator ekonomik" është prodhuesi ose importuesi, i cili furnizon tregun me produkte plehrues.
31. "Përfaqësues i autorizuar" është çdo person fizik ose juridik, i cili ka marrë të drejtën nga një prodhues për të vepruar në emër dhe në interes të tij.
32. "Përmbajtje e deklaruar për produktet plehrues" është përmbajtja e një elementi ose e formave të tij, e cila tregohet në etiketën ose dokumentin, që shoqëron një produkt plehrues.
33. "Përmbajtje e padeklaruar për produktet plehrues" është përmbajtja e një elementi ose e formave të tij, e cila tregohet në etiketën ose dokumentin, që shoqëron një produkt plehrues.
34. "Përmirësues të tokës" janë materialet, që duhet të shtohen në tokë, kryesisht për të ruajtur ose përmirësuar karakteristikat fizike ose kimike ose aktivitetin biologjik të saj, veçmas ose së bashku me njëri-tjetrin.
35. "Plehrues" është produkti, funksioni kryesor i të cilit është të sigurojë elementë ushqyes për bimët.
36. "Produkt plehrues" është lënda, përzierja, mikro-organizmi ose çdo material tjetër, që përdoret vetëm ose i përzier me material tjetër, te bimët ose rizosferën e tyre me qëllim sigurimin me elementë ushqyes ose përmirësimin e efikasitetit në të ushqyerit e bimëve.
37. "Produkt plehrues inorganik ose mineral" është produkti plehrues, në të cilin, elementët ushqyes të deklaruar, janë të pranishëm në formën e përbërjeve minerale, të përfuara nga nxjerrja ose proceset fizike dhe kimike industriale ose proceset industriale fizike ose kimike. Kalcium cianamidi, ureja dhe produktet e saj të kondensimit dhe lidhjes, si dhe produktet plehruese që përmbajnë mikroelementë të keluar ose komplekse mund të klasifikohen si produkte plehruese minerale.
38. "Produkt plehrues organik" është produkti plehrues, që rrjedh nga materialet organike me origjinë shtazore ose bimë, të përbërë nga përbërësit organikë, në të cilët elementët kryesorë të fertilitetit janë të lidhur kimikisht në formë organike ose, në çdo rast, formojnë një pjesë integrale të materialit.
39. "Produkt plehrues organo-mineral" është produkti plehrues, i përfuor nga reaksioni ose përzierja e një ose më shumë produkteve plehruese organike ose të një apo më shumë materialeve organike, ose të dyja, me një ose më shumë produkte plehruese minerale.
40. "Produkte plehrues me veprim specifik" janë produkte plehrues që kontribuojnë në mënyrë specifike në tokë, bimë ose te produktet plehrues, të cilat nxisin ose rregullojnë përthithjen e elementëve ushqyes ose korrigojnë anomalitë e caktuara fiziologjike.
41. "Produkte plehrues të veçantë" janë produktet plehrues që veprojnë si substanca për të nxitur efikasitetin dhe rregulluar përthithjen e elementëve ushqyes.
42. "Produkt plehrues thjeshtë" është produkti plehrues azotik, fosfatik ose potasik, për të cilin mund të deklarohet vetëm një nga përbërësit kryesorë të elementëve ushqyes.

43. "Produkt plehruës i përbërë" është produkti plehruës, që ka një përmbajtje të deklaruar e të paktën dy prej elementëve ushqyes parësorë dhe, të siguruar në rrugë kimike ose nga përzierja apo një kombinim i të dyjave.
44. "Produkt plehruës i përzier" është produkti plehruës, që sigurohet nga përzierja e thatë e produkteve plehruëse të ndryshme, pa shkaktuar reaksione kimike.
45. "Produkt plehruës kompleks" është produkti plehruës i përbërë, i përfutur nga reaksioni kimik, si solucion ose në gjendje të ngurtë nga granulimi, që ka një përmbajtje të deklaruar e të paktën dy prej elementëve ushqyes parësorë. Në gjendje të ngurtë çdo grimcë përmban të gjitha elementët ushqyes përbërës të tyre, të deklaruar.
46. "Produkte plehruës për bujqësinë organike" janë produktet plehruës, për të cilat lejohet përdorimi, sipas metodës së prodhimit organik.
47. "Produkt plehruës i hapur" është produkti plehruës jo i paketuar (rifuxho).
48. "Produkt plehruës i lëngshëm" është produkti plehruës në formë pezullie ose tretësire.
49. "Produkt plehruës në solucion" është produkti plehruës i lëngshëm, i lirë nga grimcat e ngurta.
50. "Produkt plehruës në pezulli (suspension) ose past" është produkti plehruës dyfazor, në të cilin grimcat e ngurta mbahen në pezulli në fazën e lëngshme ose paste.
51. "Produkt plehruës i tjetërsuar" është çdo ndryshim i treguesve të produktit plehruës nga ata të deklaruar në etiketë ose në certifikatën shoqëruëse të analizës.
52. "Prodhim" është procesi i nxjerrjes së gatshme për përdorim të produkteve plehruës.
53. "Prodhues" është çdo person fizik ose juridik, i cili prodhon një produkt plehruës ose ka një produkt plehruës të projektuar ose të prodhuar dhe e tregon atë produkt plehruës nën emrin tregtar/markën e tij.
54. "Regjistër i prodhuesve të produkteve plehruës" është tërësia e të dhënave zyrtare, ku regjistrohen prodhuesit e produkteve plehruëse në territorin e Republikës së Shqipërisë.
55. "Reklamim për produktin plehruës", çdo formë informimi, veprimtari mbështetëse ose nxitëse e destinuar për të rritur informimin për përdorimin e produktit plehruës.
56. "Seri" është një sasi e caktuar e lëndës së parë, e materialit ambalazhues, ose e produktit përfundimtar, të prodhuar gjatë një procesi të vetëm ose disa proceseve të njëpasnjëshme, e cila siguron homogjenitetin e gjithë sasisë.
57. "Substrate kultivimi" janë materialet, përveç tokës, ku rriten bimët.
58. "Tolerancë" është shmangia e lejuar e vlerave të matura të përmbajtjes së elementëve ushqyes nga vlera e deklaruar e tyre.
59. "Tregtim i produkteve plehruës" është çdo veprimtari, e cila lidhet me magazinimin, shpërndarjen, prezantimin për shitje ose shitjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të produkteve plehruës.

Neni 5

Klasifikimi produkteve plehruës

1. Produktet plehruës klasifikohen në grupe, si më poshtë vijon:
 - a) produktet plehruës inorganik ose mineral;
 - b) produktet plehruës organik;
 - c) produktet plehruës organo-mineral;
 - ç) produktet plehruës bazuar në elementë ushqyes dytësorë;
 - d) produktet plehruës bazuar në mikroelementë;
 - dh) produktet plehruës me veprim specifik;
 - e) produktet plehruës të veçantë;
 - ë) korrektuesit (korrigjuesit);
 - f) substratet e kultivimi (rritje);
 - g) përmirësuesit e tokës

- g) materialet organike të destinuara për prodhimin e produkteve plehrues organo-mineral.
2. Klasifikimi i hollësishëm i produkteve plehrues si dhe i përmbajtjes së tyre miratohet me udhëzim ministri.

KREU II

PRODHIMI I PRODUKTEVE PLEHRUES

Neni 6

Miratimi i prodhimit

1. Prodhimi i produkteve plehruese në Republikën e Shqipërisë kryhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, parimet dhe udhëzimet e praktikës së prodhimit të mirë dhe legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.
2. Prodhimi i produkteve plehrues në vend kryhet nga persona juridikë ose fizikë pas miratimit të prodhimit nga ministri përgjegjës, sipas propozimit të komisionit të verifikimit të kushteve të prodhimit të produkteve plehrues (KVKPPP).
3. Prodhimi i produkteve plehrues me rrezikshmëri kryhet nga persona fizikë ose juridikë të licencuar për këtë veprimtari, pas miratimit të prodhimit nga ministri përgjegjës, sipas propozimit të komisionit të verifikimit të kushteve të prodhimit të produkteve plehrues.
4. Miratimi i prodhimit lëshohet për prodhimin e plotë të produkteve plehrues nga lënda e parë deri në produktin përfundimtar.
5. Miratimi i prodhimit është i detyrueshëm edhe për produkte plehruese të prodhuara në vend, të destinuara për eksport.
6. Lista e produkteve plehrues me rrezikshmëri përcaktohet me urdhër ministri.
7. Afati kohor për miratimin e prodhimit është 60 ditë nga dita e aplikimit.
8. Kërkesat paraprake për miratimin e prodhimit, kërkesat për mbajtësin e miratimit të prodhimit dhe detyrimet e prodhuesit në vend përcaktohen me udhëzim ministri.
9. Komisioni i verifikimit të kushteve të prodhimit të produkteve plehrues, ngrihet me urdhër të ministrit dhe funksionon në përputhje me rregulloren e miratuar prej tij.

KREU III

REGJISTRIMI I PRODUKTEVE PLEHRUES.

Neni 7

Kërkesat që duhet të plotësohen për regjistrimin e produkteve plehrues

Një produkt plehrues mund të regjistrohet nëse përmbush kërkesat si vijon:

- a) grupi dhe llojet e tij si dhe përbërësit për çdo lloj janë të miratuar me urdhër të ministrit;
- b) lënda ushqyese garanton siguri, cilësi dhe efektshmëri;
- c) ekzistojnë metodat e analizave dhe të testimeve;
- ç) nuk ndikon negativisht në shëndetin e njerëzve, kafshëve, bimëve dhe mjedisin;
- d) përmbush të gjitha kërkesat për ambalazhimin, etiketimin dhe magazinimin, sipas dispozitave të këtij ligji;
- dh) përmbush kufijtë e tolerancës.

Neni 8

Të dhënat e dosjes dhe procedura për regjistrimin e produkteve plehrues

1. Të dhënat, në përmbajtje të dosjes, që kërkohen për regjistrimin e produktit plehrues, përmbajnë:
 - 1.1. kërkesën e aplikantit për regjistrimin e produktit plehrues, në gjuhën shqipe;
 - 1.2. etiketën, të përkthyer dhe në gjuhën shqipe;
 - 1.3. dokumentacionin për të dhënat e sigurisë (MSDS). MSDS të jetë e përkthyer dhe në gjuhën shqipe;
 - 1.4. përmbajtjen e të dhënave të dosjes së regjistrimit të produktit plehrues, në gjuhën shqipe ose anglisht, në dosje dhe në formë elektronike (CD).
2. Përmbajtja e të dhënave të dosjes së regjistrimit të produkteve plehrues, si dhe përditësimi i tyre, miratohet me urdhër të ministrit.
3. Procedura e regjistrimit miratohet me udhëzim ministri.

Neni 9

Lista e produkteve plehrues dhe lista e prodhuesve të produkteve plehrues

1. DPPP përgatit listën e produkteve plehrues dhe listën e prodhuesve të produkteve plehrues, dhe i publikon në faqen zyrtare të ministrisë sa herë që pësojnë ndryshime.
2. Lista e produkteve plehrues përmban këto të dhëna:
 - a) emrin tregtar;
 - b) përmbajtjen e çdo përbërësi të produktit plehrues;
 - c) emrin e aplikantit;
 - ç) prodhuesin (emrin, adresën e fabrikimit);
 - d) grupin;
 - dh) numrin dhe datën e regjistrimit.
 - e) importuesin.
3. Lista e prodhuesve të produkteve plehrues përmban këto të dhëna:
 - a) prodhuesin (emrin, adresën e selisë ose të fabrikimit të produkteve plehrues);
 - b) emrin/at tregtar të produkteve plehrues, që prodhon;
 - c) grupin;
 - d) numrin dhe datën e regjistrimit;
 - ç) emrin/at lëndëve të para, që përdor për prodhimin e produkteve plehrues.

Neni 10

Tarifat administrative për regjistrimin e produkteve plehrues

1. Tarifat administrative për regjistrimin e produkteve plehruës përballohen nga aplikantët dhe derdhen në buxhetin e shtetit.
2. Tarifat administrative përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat.

Neni 11

Dokumenti i regjistrimit të produktit plehruës

1. Dokumenti i regjistrimit të produktit plehruës përmban certifikatën e regjistrimit dhe etiketën. Certifikata e regjistrimit lëshohet nga kryetari i komisionit, jo më vonë se 5 ditë nga data e mbledhjes së komisionit dhe shoqërohet me etiketën.

Dokumenti i regjistrimit mbahet në tri kopje origjinale, nga të cilat njëra mbahet në arkivin e ministrisë, njëra në arkivin e DPPP-së, ndërsa kopja tjetër i jepet aplikantit.

2. Në certifikatën e regjistrimit, e cila plotësohet në gjuhën shqipe, jepen të dhënat, si më poshtë vijon:

- a) emri tregtar;
- b) numri dhe data e regjistrimit;
- c) emri i aplikantit dhe adresa e tij;
- ç) emri i prodhuesit ose përgjegjësi për vendosjen e tij në treg në Shqipëri si dhe adresa e tij;
- d) grupi;
- dh) pamja e jashtme e tij;
- e) përmbajtja;
- ë) afati i vlefshmërisë;
- f) mënyra e përdorimit (me shënimin: shih etiketën bashkëlidhur).

3. Në etiketën e produktit plehruës jepen të dhënat, si më poshtë vijon:

- a) emri tregtar;
- b) numri dhe data e regjistrimit;
- c) emri i aplikantit dhe adresa e tij;
- ç) emri i prodhuesit dhe adresa e tij;
- dh) emri i grupit, i cili shkruhet me germa kapitale;
- e) pamja e jashtme e tij;
- ë) përmbajtja e përbërësve të produktit plehruës, përfshirë edhe përmbajtjen e elementeve të përshkruara me fjalë dhe simbole kimike dhe në lidhje me ushqyesit e format e tretshme;
- f) numri i serisë;
- g) mënyra e përdorimit;
- gj) sasia neto e produktit plehruës, që ndodhet në ambalazhin bazë;
- h) instruksionet për asgjësimin e ambalazheve;
- i) afati i ruajtjes;
- j) kushtet e ruajtjes.

Përmbajtja e etiketës të jetë në gjuhën shqipe.

Neni 12

Riregjistrimi i produkteve plehruës, çregjistrimi dhe modifikimi i dokumentave të regjistrimit të produkteve plehruës, të regjistruar

1. Riregjistrimi i produktit plehrues bëhet direkt nga komisioni, kur kjo kërkohet nga aplikanti para përfundimit të afatit të regjistrimit.
2. Çregjistrimi i produktit plehrues kryhet nga kryetari i komisionit në rastet kur:
 - a) produkti plehrues përmban lëndë ushqyese, të cilat janë të hequra me urdhër të ministrit;
 - b) aplikanti e kërkon, me shkrim, një gjë të tillë;
 - c) ka përfunduar afati i regjistrimit të tij, dhe nuk është bërë kërkesë nga aplikanti për riregjistrim;
 - ç) nuk vazhdon të plotësojë kërkesat sipas nenit 6 të këtij ligji.

Në rastet e çregjistrimit njoftohet aplikanti.

Pas çregjistrimit, nëse produkti plehrues është ende në treg, duhet të përdoret brenda afateve të skadencës së tij.

3. Modifikimi i dokumentit të regjistrimit të produktit plehrues kryhet kur ka ndryshim të
 - a) emrit tregtar;
 - b) mbajtësit të dokumentit të regjistrimit (aplikanti);
 - c) prodhuesit;
 - ç) prodhimit (shtim, transferim në një stabiliment tjetër prodhues);
 - d) mënyrave të përdorimit dhe sasive të përdorura;
 - dh) periudhës dhe kushteve të ruajtjes;
 - d) zgjerimit të fushës së përdorimit
- Në të gjitha rastet e përcaktuara në këtë pikë, aplikanti duhet të paraqesë kërkesë në gjuhën shqipe.

KREU IV

TREGTIMI, TRANSPORTI, RUAJTJA, ETIKETIMI DHE PËRDORIMI I PRODUKTEVE PLEHRUES

Neni 13

Tregtimi i produkteve plehrues

1. Lejohet vetëm importimi dhe tregtimi i produkteve plehrues të regjistruar.
2. Tregtimi i produkteve plehrues me rrezikshmëri përfshihet në kategorinë II.5, të shtojcës së ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
3. Në njësitë e tregimit të produkteve plehrues ndalohet:
 - a) mbajtja dhe tregtimi i produkteve plehrues në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;
 - b) asgjësimi i ambalazheve dhe i produkteve plehrues të skaduara apo të dëmtuara;
 - c) mbajtja dhe tregtimi i ushqimeve për njerëz dhe kafshë;
 - ç) riambalazhimi i produkteve plehrues, pasi janë vendosur në treg.
4. Inspektori i mbrojtjes së bimëve në pikat e kalimit kufitar (PIK) ka për detyrë:
 - a) të kontrollojë dhe verifikojë produktet plehrues, që hyjnë për t'u përdorur në Republikën e Shqipërisë, dhe t'i evidentojë ato në një regjistër të veçantë;
 - b) të ndalojë hyrjen në Republikën e Shqipërisë, të produkteve plehrues të pa regjistruara.

Neni 14

Transporti, ruajtja dhe magazinimi i produkteve plehrues

1. Transporti i produkteve plehrues bëhet me çdo lloj mjeti, të pajisur me karroceri të rregullt, të mbuluar tërësisht, poshtë dhe lart, me plastmas ose mushama, si masë mbrojtjeje, në çdo rast, nga kontakti me lagështirën dhe nga rrjedhjet gjatë udhëtimit.
2. Të gjitha produktet plehrues, pas prodhimit apo sjelljes nga importi, ruhen në magazinat e tregtimit me shumicë, si dhe në mjediset e tregtimit me pakicë.
3. Kushtet në magazinat dhe njësitë e tregtimit me pakicë duhet të garantojnë ruajtjen e cilësive fiziko-kimike të produkteve plehrues, sipas kërkesave të përcaktuara në etiketë.
4. Magazinat dhe njësitë e tregtimit me pakicë të produkteve plehruese duhet të jenë të pajisura me:
 - a) mjetet e nevojshme për asgjësimin e produkteve plehrues të rrjedhura ose të dëmtuara;
 - b) këndin e ndihmës së shpejtë dhe mjetet mbrojtëse individuale;
 - c) pajisjet e mbrojtjes nga zjarri;
 - ç) mjediset higjieno-shëndetësore me ujë të rrjedhshëm;
 - d) magazinat të jenë të pajisura me sistemet e duhura të ajrimit.
5. Produktet plehrues gjatë magazinimit duhet të:
 - a) jenë të ndara nga njëra-tjetra;
 - b) jenë të etiketuara në mënyrë të qartë;
 - c) mos jenë të përziera me substanca të tjera.

Neni 15

Ambalazhimi dhe etiketimi i produkteve plehrues

1. Produktet plehrues mund të vendosen në treg vetëm të ambalazhuar.
2. Ambalazhi duhet të ruajë karakteristikat fizike dhe kimike të produkteve plehrues.
3. Ambalazhi parësor, që është në kontakt direkt me produktin plehrues, duhet të jetë i mbyllur në mënyrë të tillë që, në rast se hapet, nuk duhet të përdoret përsëri.
4. Etiketa të jetë e ngjitur në mënyrë të pashqitëshme në ambalazhin parësor të produktit plehrues si dhe përmbajtja e saj të jetë qartësisht e lexueshme dhe jo e shujtshme.

Neni 16

Përdorimi i produkteve plehrues

1. Lejohet vetëm përdorimi i produkteve plehrues të regjistruar.
2. Produktet plehrues përdoren nga përdoruesi i fundit, duke respektuar kërkesat dhe udhëzimet, që jepen në etiketë.
3. Përdorimi i produkteve plehrues të sigurojë mbrojtjen e shëndetit të përdoruesve, konsumatorëve, kafshëve dhe mjedisit.

4. Rregullat e hollësishme për ruajtjen, ambalazhimin, etiketimin dhe përdorimin e produkteve plehrues, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

KREU V

KUFIJTË E TOLERANCËS. PRODUKTET PLEHRUES TË NITRATIT TË AMONIT, ME PËRMBAJTJE TË LARTË AZOTI

Neni 17

Kufijtë e tolerancës

1. Përmbajtja e deklaruar në produktet plehrues duhet të jetë në përputhje me kufijtë e tolerancës.
2. Në përcaktimin e kufive të tolerancës merren parasysh, variacionet në aspektin e prodhimit, marrjes së mostrave për analizë, pasiguritë e matjeve si dhe metodat analitike të përdorura.
3. Kufijtë e tolerancës miratohen me urdhër të ministrit.

Neni 18

Produktet plehrues të nitratisë të amonit, me përmbajtje të lartë azoti

1. Produktet plehrues me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë azoti, janë produkte me bazë nitrat amoni, të prodhuara për t'u përdorur si produkte plehrues dhe që përmbajnë mbi 28 për qind në masë të azotit në raport me nitratin e amonit. Kjo kategori e produktit plehrues mund të përmbajë substanca inorganike ose inerte. Substancat, që janë përdorur në prodhimin e këtij tipi plehu, nuk duhet të rrisin ndjeshmërinë e tij ndaj nxehtësisë dhe ndaj shpërthimit.
2. Prodhuesi duhet të sigurojë që produktet plehrues të thjeshtë me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë të azotit, duhet të plotësojnë kërkesat e këtij ligji.
3. Kontrolli, analizat dhe testimet zyrtare të produkteve plehrues të thjeshtë me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë të azotit, të referuar në këtë nen, duhet të jenë në përputhje të plotë me metodat e përcaktuara me udhëzim të ministrit.
4. Për të siguruar kontrollin e produkteve plehrues të thjeshtë me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë të azotit, të vendosura në treg, prodhuesi mban një regjistër të veçantë vetëm për këtë lloj produkti plehrues, ku përcaktohen emri, adresa dhe vendndodhja e prodhuesit, si dhe e përdoruesve të tij. Ky regjistër duhet të jetë i disponueshëm për kontrollet që kryhen për të gjithë periudhën e vendosjes në treg të këtij produkti plehrues.
5. Prodhuesi duhet të sigurojë që produkti plehrues me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë të azotit, që vendoset në treg, të ketë kaluar testin e rezistencës ndaj shpërthimit. Ky test duhet të jetë bërë në laboratorë të akredituar, që plotësojnë kërkesat e standardeve S SH EN 17025, S SH EN 45003 apo të standardeve të njëvlershme me to dhe i shoqëruar me certifikatën origjinale të rezistencës ndaj shpërthimit. Kalimi i testit të shpërthyeshmërisë është kusht i domosdoshëm për të gjitha produktet plehrues që vendosen në treg.
6. Produktet plehrues me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë azoti, duhet të jenë të disponueshëm përpara përdorimit përfundimtar, vetëm në formë të paketuara.

KREU VI

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE

Neni 19

Organizimi

Strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, janë:

- a) Drejtoria përgjegjëse për produktet plehrues (DPPP) në ministri;
- b) Shërbimi i mbrojtjes së bimëve pranë agjencisë rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve (ARSHVMB);
- c) Komisioni i regjistrimit të produkteve plehrues (KRPP);
- ç) Laboratori kombëtar i referencës dhe laboratorët e miratuar të kontrollit.

Neni 20

Drejtoria përgjegjëse për produktet plehrues

Drejtoria përgjegjëse për produktet plehrues është drejtoria përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve në ministri dhe ka këto detyra:

- a) është autoriteti kompetent që harton politikat dhe përshtatjen e legjislacionit të produkteve plehrues me atë të BE-së;
- b) zhvillon procedurat që lidhen me regjistrimin e produkteve plehrues;
- c) ndjek dhe monitoron aktivitetin e produkteve plehrues në nivel qendror dhe rajonal, në zbatim të këtij ligji.

Neni 21

Shërbimi i mbrojtjes së bimëve pranë agjencisë rajonale të SHVMB-së

Shërbimi i mbrojtjes së bimëve pranë ARSHVMB-së mbikëqyr e kontrollon prodhimin, importimin, eksportimin, ruajtjen, tregtimin dhe përdorimin e produkteve plehrues, në zbatim të këtij ligji dhe të akteve nënligjore që rrjedhin prej tij.

Neni 22

Komisioni i regjistrimit të produkteve plehrues

1. Komisioni i regjistrimit të produkteve plehrues funksionon në mënyrë periodike në procedurën e regjistrimit të produkteve plehrues.
2. Komisioni është organ kolegjal teknik i përhershëm dhe vendimmarrës. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, si më poshtë:
 - a) zëvendësministri, i cili kryeson komisionin;
 - b) dy përfaqësues nga drejtoria përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve në ministri;
 - c) një përfaqësues nga laboratorit kombëtar i referencës;
 - ç) një përfaqësues nga ARSHVMB.

Sekretar i komisionit të regjistrimit të produkteve plehrues është specialisti, që mbulon produktet plehrues pranë drejtorisë përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve në ministri.

3. Lista emërore e antarëve të komisionit miratohet me urdhër të ministrit, pas propozimit të bërë nga institucionet përkatëse.
4. Funksionimi i komisionit rregullohet me udhëzim të ministrit.

Neni 23

Laboratori kombëtar i referencës dhe laboratorët e miratuar të kontrollit

1. Laboratori kombëtar i referencës ka për detyrë:
 - a) kontrollin cilësor të produkteve plehrues të hedhura në treg;
 - b) vlerësimin e dokumentacionit të produkteve plehrues gjatë procedurës së regjistrimit të tyre;
 - c) respektimin dhe garantimin e të gjitha shërbimeve të nevojshme për verifikimin e përputhshmërisë së produkteve plehrues me kërkesat e këtij ligji;
 - ç) vlerësimin e laboratorëve të miratuar të kontrollit, me qëllim:
 - i. miratimin e tyre si laboratorë të miratuar për kryerjen e analizave të kontrolleve zyrtare,
 - ii. bashkërendimin e punës dhe dhënien e mbështetjes, përfshirë trajnimet dhe shërbime të tjera për veprimtaritë laboratorike, për standardet teknike dhe mënyrat e analizave që ato kryejnë,
 - iii. organizimin e testeve paralele të mostrave të standardizuara dhe marrjen pjesë në to në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për monitorimin e kualifikimit të tyre,
 - iv. garantimin e përdorimit të një sistemi të brendshëm, në përputhje me standardet e kërkuara.
2. Laboratori kombëtar i referencës për produktet plehrues miratohet me urdhër të ministrit.
3. Laboratorët e miratuar të kontrollit mund të jenë publikë ose privatë.
4. Kriteret e përgjithshme dhe procedurat për miratimin e laboratorëve të kontrollit të produkteve plehrues hartohen nga laboratori kombëtar i referencës dhe miratohen me udhëzim të ministrit.
6. Laboratorët e kontrollit miratohen me urdhër të ministrit, pas vlerësimit të kryer nga laboratori kombëtar i referencës për përmbushjen e kriterëve, sipas germës ç), të pikës 1, të këtij neni, dhe sipas llojit të analizave për të cilat kërkojnë të miratohen.
7. Metodatat e analizave të produkteve plehruese miratohen me urdhër të ministrit.
8. Tarifatat e shërbimeve dhe të analizave, që kryhen nga laboratori kombëtar i referencës dhe laboratorët e miratuar të kontrollit, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat.

KREU VII

ANALIZIMI, GJURMUESHMËRIA DHE PUBLICITETI I PRODUKTEVE PLEHRUES

Neni 24 **Analizimi**

1. Analizat laboratorike të mostrave të produkteve plehrues bëhen në laboratorin e referencës dhe në laboratorët e miratuar të kontrollit, sipas metodave të përcaktuara në pikën 6, të nenit 24 të këtij ligji.
2. Rezultati përfundimtar i analizave jepet brenda një periudhe kohe prej 10 ditësh pune nga çasti i dorëzimit të mostrës për analizim.

Neni 25

Gjurmueshmëria

1. Gjurmueshmëria përcaktohet në të gjitha nivelet e prodhimit, tregtimit dhe përdorimit të produkteve plehrues.
2. Prodhuesit dhe tregtuesit e produkteve plehrues krijojnë sisteme për mbajtjen e të dhënave, të cilat mundësojnë identifikimin në çdo cast të produktit plehrues si dhe çdo personi fizik apo juridik, që i ka furnizuar apo është furnizuar me produkte plehrues. Këto të dhëna ruhen për tre vjet dhe vihet në dispozicion të ARSHVMB-së.
3. Për qëllimet e gjurmueshmërisë së produkteve plehrues, nga drejtoria përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve në ministri, mbahen "Regjistri i produkteve plehrues", i cili përmban një seksion të veçantë për ata që lejohen në bujqësinë organike, si dhe "Regjistri i prodhuesve të produkteve plehrues".

Neni 26

Veprimtari të ndaluara

1. Ndalohet prodhimi, importi, vendosja në treg dhe përdorimi i:
 - a) produkteve plehruese të paregjistruara;
 - b) produkteve plehrues me përmbajtje substancash të dëmshme, të cilat mund të përbëjnë rrezik për sigurinë ose shëndetin e njerëzve, kafshëve ose bimëve ose një rrezik për mjedisin ose për sigurinë publike;
 - c) produkteve plehrues të falsifikuar;
 - ç) produkteve plehrues të tjetërsuar;
 - d) produkteve plehrues me përmbajtje të padeklaruar.

Neni 27

Mungesa në peshë

Pesha neto e produkteve plehrues të ambalazhuar për tregtim duhet të jetë e njëjtë me atë të shkruar në etiketë. Toleranca e lejueshme është deri në 1 %.

Neni 28

Informimi dhe reklamimi i produkteve plehrues

1. Ministria informon në ëeb e saj, median e shkruar ose elektronike, prodhuesit, importuesit, tregtuesit, listën e produkteve plehruese që lejohet të qarkullojnë në vendin tonë si dhe veprimtaritë e organizuara lidhur me sigurinë, cilësinë, efektshmërinë, përdorimin dhe parandalimin e rreziqeve nga tregtimi dhe përdorimi i produkteve plehrues.

2. Reklamimi në median e shkruar ose elektronike, bëhet nga aplikanti dhe lejohet vetëm për produkteve plehrues të regjistruara dhe në përputhje me dokumentin e regjistrimit.
3. Ndalohet reklamimi në median e shkruar ose elektronike i produkteve plehruese me rezikshmëri.

KREU VIII

KUNDËRVAJTJE ADMINISTRATIVE

Neni 29

Kundërvajtje administrative

1. Kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e mëposhtme të dispozitave të këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me:
 - a) gjobë 50 mijë lekë, në rastet kur veprohet në kundërshtim me pikën 2, të nenit 25 të këtij ligji;
 - b) gjobë 100 mijë lekë, në rastet kur veprohet në kundërshtim me pikën 3, të nenit 13; pikat 4 dhe 5, të nenit 14; nenin 15; pikën 1, të nenit 17, dhe pikën 4, të nenit 18, të këtij ligji;
 - c) gjobë 200 mijë lekë, në rastet kur veprohet në kundërshtim me pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 6; pikat 1 dhe 2, të nenit 13 dhe pikat 1, 2 e 6, të nenit 19, të këtij ligji;
 - ç) gjobë 500 000 lekë, në rastet kur veprohet në kundërshtim me nenet 26 dhe 27, si dhe në rast përsëritjeje të kundërvajtjeve administrative të parashikuara në pikat 1 dhe 2, të nenit 13; pikën 1, të nenit 6 dhe pikat 1, 2 e 6, të nenit 19, të këtij ligji.
2. Për shkeljet e dispozitave të këtij ligji, të cilat sipas pikës 1, të këtij neni, përbëjnë kundërvajtje administrative, përveç masës së vënies së gjobës, e cila është dënim kryesor, vendosen edhe dënime plotësuese si masa e kthimit të ngarkesave, e heqjes së licencës, e heqjes së të drejtës së tregtimit me shumicë ose pakicë, si dhe masa urgjente, si masa e bllokimit në rastin e shkeljeve të dispozitave të nenit 26, të këtij ligji.
3. Të gjitha të ardhurat nga gjobat derdhen në buxhetin e shtetit.

Neni 30

Procedurat e kundërvajtjes administrative

1. Të drejtën e dhënies së masës administrative, siç është përcaktuar në nenin 29, të këtij ligji, e ka specialisti pranë ARSHVMB-së.
2. Kundër vendimit mund të bëhet ankim ose ankim i veçantë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Procedura e konstatimit dhe vendosjes do të bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

KREU IX

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 31
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet ministri të nxjerrë brenda një viti pas hyrjes në fuqi, aktet nënligjore në zbatim të nenit 5; të pikës 2, të nenit 7; të pikës 4, të nenit 13; të pikës 3, të nenit 16; të pikës 4, të nenit 17; të pikës 4, të nenit 23 dhe të pikave 2, 4, 5 dhe 6, të nenit 24, të këtij ligji.
2. Ngarkohen ministri dhe ministri përgjegjës për financat, të nxjerrin brenda një viti pas hyrjes në fuqi, aktet nënligjore në zbatim të pikës 2, të nenit 9 dhe të pikës 7, të nenit 24, të këtij ligji.

Neni 32
Dispozita kalimtare

Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore të përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji, mbeten në fuqi aktet nënligjore, të dala në zbatim të ligjit nr. 10390, datë 3.3.2011, "Për plehrat e përdorimit për bimësinë", për aq sa përputhen me ligjin në fuqi.

Neni 33
Shfuqizimet

Ligji nr. 10390, datë 3.3.2011, "Për plehrat e përdorimit për bimësinë", shfuqizohet.

Neni 34
Hyrja në fuqi

Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij ligji.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.